



KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të LVL dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr.016-126211, të dt. 06.11.2014 me ndryshime dhe plotësime në Statut 01.nr.01628448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës në cilësinë e organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës nxjerr:

**V E N D I M**

1. Me këtë vendim, nëpunësi civil Burim Maliqi, i caktuar në detyra punuese: Zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e Avokatit të Komunës, **Autorizohet** që t'i kryej detyrat punuese: Përfaqësues ligjor i Komunës, në kuadër të Zyrës së Avokatit të Komunës për periudhën shkurt, prill, qershor 2023 për shkak se Përfaqësuesi ligjor i Komunës gjendet në pezullim të dakorduar.
2. Nëpunësi civil, i autorizuari, do t'i ushtroj të drejtat dhe përgjegjësitë e Përfaqësuesit ligjor të Komunës në pajtim me dispozitat ligjore.
3. Me rikthimin e Përfaqësuesit ligjor të Komunës nga pezullimi i dakorduar, i autorizuari kthehet në detyrat e mëparme punuese para autorizimit.
4. Gjatë periudhës së zëvendësimit i autorizuari ruan të drejtën e pagesës së diferencës në pagë nëse ekziston në mes të pozitës punuese në të cilën është caktuar dhe asaj të cilën e ushtron përkohësisht.
6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
7. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- Burim Maliqi
- Njësisë së personelit

